



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) dhe 53, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 8 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, e konform nenit 29 lidhur me nenin 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 14.12.2021, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Me këtë vendim emërohet-plotësohet, Komiteti për Komunitete, me anëtarë me këtë përbërje:

1. Doruntina ZENELAJ-----LDK
2. Afërdita MORINA-----AAK
3. Aziz BYTYQI-----AAK
4. Melisa SHABANAJ-----PDAK
5. Denis SOFRA -----PAI
6. Zekë BERISHA-----ROM
7. Nazim SHABANAJ-----PE

### Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në nenin 53, të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” dhe në nenin 41, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

### Neni 3

Mandat i anëtareve të Komitetit për Komunitete, zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i Kuvendit të Komunës në Suharekë.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË

01-Nr- 41076545  
Me date 14.12.2021



Kryesuesi i Kuvendit  
Mr. Bexhet KUÇI